



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rruga: "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel/Fax 04 22268141; 22268142

Nr. 49/5 Prot.

Tiranë, më 03.04.2017

V E N D I M

Nr. 69, datë 03.04.2017

***"Mbi përfundimin e procedimit administrativ,
filluar me urdhrin e verifikimit nr. 49/1 prot., datë 03.02.2017"***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; neneve 79 – 90, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e informacionit të protokolluar pranë Komisionerit me nr. 49 prot., datë 30.01.2017, për disa pretendime të ngritura në lidhje me procedurën e vlerësimit në fund të periudhës së provës për punonjësin *****,

VËREJ SE:

Me Urdhrin nr. 49/1 prot., datë 03/02/2017, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u shqyrtua informacioni i përcjellë nëpërmjet ankesës, paraqitur nga punonjësi ***** në lidhje me procedurën e vlerësimit në fund të periudhës së provës.

Në zbatim të urdhrit të mësipërm, nëpërmjet shkresës nr. 49/2, datë 03.02.2017, "Njoftim mbi fillimin e verifikimit", është vënë në dijeni Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për këtë proces, duke i kërkuar edhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e tij.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, nga institucioni është dërguar shkresa nr. 2714/1 prot, datë 10.02.2017, drejtuar Komisionerit dhe së bashku me të, është dërguar edhe dokumentacioni përkatës, i cili është administruar në dosjen e materialeve të mbledhura gjatë hetimit administrativ.

Nga analiza e këtij rasti rezulton se, ky punonjës pas kryerjes së procedurës së konkurrimit me aktin nr. 5834 prot., datë 24.11.2015 të DAP, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove me detyrë "Inspektor i Dytë", në Sektorin e Verifikimit në Terren, në Drejtorinë e Kontrollit

Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Durrës. Në mbështetje të aktit të emërimit, ai ka filluar marrëdhënien financiare të punës me Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës, me aktin nr. 936, datë 01.12.2015, të titullari të institucionit.

Më tej rezulton se, për shkak të ristrukturimit të institucionit, me vendimin nr. 1229, datë 21.11.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, pas miratimit nga DAP, ai është transferuar në pozicionin e punës “*Inspektor i Dytë*”, në Sektorin e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës.

Në kuadër të procesit të verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave si dhe cilësive të nëpunësit ***** në kryerjen e detyrave, në përfundim të periudhës një vjeçare të provës, është kryer vlerësimi i rezultateve në punë dhe formulari i plotësuar, i është paraqitur këtij të fundit për nënshkrim, në datën 19.01.2017.

Nga analiza e këtij akti, konstatohet se ai është nënshkruar nga të gjithë personat përgjegjës, të ngarkuar nga ligji për kryerjen e procedurës së vlerësimit (*zyrtari raportues, zyrtari kundërfirmues dhe zyrtari autorizues*), dhe se vlerësimi përfundimtar është në **nivelin 4**, “*Jo kënaqshëm*”.

Ndaj këtij vlerësimi, punonjësi ***** është ankuar pranë titullarit të institucionit, duke bërë shënimin përkatës në faqen 6 të formularit, sipas përcaktimeve të Kreut V, të vendimit nr.109, datë 26.02.2014, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar. Ndërkaq, nga ana e drejtuesit të institucionit (*Zyrtari autorizues*), në rubrikën, ndarja DH: “*Vlerësimi nga zyrtari autorizues*”, është bërë shënimimi me shkrim dore: “***Nuk ka argumenta ligjore për rivlerësimin***”.

Megjithatë, eprori direkt, nuk është mjaftuar me përfundimin e arritur në vlerësimin në fund të afatit një vjeçar të periudhës së provës për nëpunësin ***** dhe me qëllim verifikimin e konkluzioneve, si dhe dhënien e një mundësie të dytë këtij nëpunësi, për të shprehur cilësitë tij, bazuar në pikën 3, germa “*b*”, të nenit 24, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe pikën 7, të Kreut VI, “*Periudha e provës*”, të Vendimit nr. 243 dt. 18.03.2015 “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*” të Këshillit të Ministrave, me aktin nr. 485/1 prot., datë 09.02.2017, “*Vendim për shtyrje 6 muaj të periudhës së provës*”, ka vendosur shtyrjen e periudhës së provës për gjashtë muaj.

Në këtë rast, ky akt është i bazuar në ligj dhe në diskrecionin e eprorit direkt, por në këtë moment, duke analizuar në tërësi dokumentacionin e vlerësimit në fund të periudhës së provës, mbledhur gjatë kryerjes së këtij hetimi administrativ, vlerësohet se duhet të evidentohen disa të meta, të cilat duhet të mbahen parasysh në të ardhmen për t’i evituar dhe përmirësuar gjatë përmbylljes së procesit të vlerësimit, në përfundim të periudhës së provës (*pas shtyrjes, për 6 muaj*).

Në kuptim të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, vlerësimi i rezultateve në punë në përfundim të periudhës së provës, është vjetor dhe llogaritet nga data e emërimit të nëpunësit civil në detyrë. Për realizimin e një vlerësimi sa më objektiv, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 26.02.2014, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve*

civil”, i ndryshuar, është përcaktuar dhe procedura që duhet të respektohet për procesin e vlerësimit të rezultateve në punë si dhe kompetencat për vlerësimin.

Sipas pikës 12, Kreu II, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 26.02.2014, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil*”, i ndryshuar, procesi i vlerësimit të rezultateve në punë, ashtu si edhe vlerësimi i punës në fund të periudhës së provës, duhet të kalojë në fazat e mëposhtme:

- *Planifikimi*, ku zyrtari raportues (*i cili, si rregull, është edhe eprori direkt*) takohet me nëpunësin civil që do të vlerësohet për të caktuar objektivat kryesore të punës dhe sjelljet përkatëse profesionale që bëjnë të mundur realizimin e planit të punës, përmbushjen e objektiveve dhe të misionit të institucionit. Në këtë fazë zyrtari raportues së bashku me nëpunësin në provë, që do të vlerësohet diskutojnë qëllimet e nëpunësit për karrierë, aspiratat dhe çdo gjë tjetër që lidhet me trajnimin dhe zhvillimin profesional.
- *Bisedimet e ndërmjetme*. Kjo fazë konsiston në takime të strukturuar dhe të shkurtra, të cilat zhvillohen në mes të periudhës së vlerësimit, ku zyrtari raportues takohet me nëpunësin civil dhe vlerëson progresin e bërë në arritjen e objektiveve të planifikuara dhe përmirësimet e nevojshme, në planin e hartuar me shkrim.
- *Vlerësimi përfundimtar*, i cili realizohet në përfundim të vitit të provës, konsiston në vlerësimin e përmbledhur të nivelit të suksesit të nëpunësit që do të vlerësohet në arritjen e objektiveve kryesore të punës, të përcaktuara në fazën e planifikimit dhe të rishikuar gjatë bisedimeve të ndërmjetme.

Në rastin konkret nuk ka të dhëna nëse procedura e mësipërme është respektuar nga ana e zyrtarit raportues, pasi nuk disponohet dokumentacion që materializon zhvillimin e fazave të mësipërme. Mosrespektimi i kësaj procedure reflektohet dhe në mungesën e komenteve në disa prej rubrikave të rëndësishme të formularit të vlerësimit, konkretisht në ndarjen C, “*Objektivat dhe matësit e performancës*” dhe në ndarjen Ç, “*Sjelljet profesionale*”.

Procedura e vlerësimit të nëpunësit civil, sipas formatit të miratuar nga Departamenti i Administratës Publike, krahas vlerësimit me pikë, është e detyrueshme të përmbajë dhe komentet përkatëse në lidhje me vlerësimin përfundimtar, arsyet e këtij vlerësimi si dhe rekomandimet apo vërejtjet e nevojshme, me qëllim rritjen e rezultateve dhe arritjen e objektiveve më të larta. Respektimi i këtij detyrimi ligjor, ndikon në një vlerësim objektiv dhe të matshëm, të performancës dhe arritjeve të nëpunësit civil gjatë kryerjes së detyrave të tij. Për më tepër, ky proces duhet të ndihmojë nëpunësin që në të ardhmen të përqendrohet në ato drejtime të treguara, me qëllim përmbushjen sa më mirë të detyrave dhe nxitjen e rritjes së rezultateve në punë. Mosrespektimi i procedurës së përcaktuar në aktin nënligjor, mungesa e dokumentacionit provues të zhvillimit të kësaj procedure dhe përdorimi i komenteve të njëjta në të gjitha rubrikat, sjell një vlerësim jo objektiv dhe jo të plotë, në lidhje me punën e kryer nga nëpunësi.

Të metat e mësipërme të konstatuara në procesin e vlerësimit, kanë patur ndikimin e vet edhe në ecurinë në punë të punonjësit *****, i cili pasi është vënë para faktit të vlerësimit negativ, ka mbetur i paqartë dhe ka shprehur menjëherë mosdakordësinë e tij me vlerësimin, duke kërkuar rishqyrtimin e tij nga zyrtari autorizues (*fakt i cili gjen pasqyrim në ndarjen D, “Nënshkrimi”, drejtuar zyrtarit autorizues*).

Nga sa parashtruar më sipër dhe nga analiza në tërësi e dokumentacionit, arrijmë në konkluzionin se në vlerësimin përfundimtar, në fund të periudhës së provës për punonjësinn *****, zyrtari raportues, duhet të mbajë parasysh dhe të respektojë në tërësi procedurën e sistemit të vlerësimit të rezultateve në punë e parashikuar, në vendimin nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil”, i ndryshuar.

Për këtë arsye, në bazë të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH” dhe në zbatim të neneve 2, pika 2, germa “a”, neni 16 pika 6, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, si dhe të faktit që procesi administrativ i konfirmimit të nëpunësit civil dhe vlerësimit përfundimtar të tij, në fund të periudhës së provës nuk është përfunduar, vlerësohet se duhet të vendoset përfundimi i procedimit administrativ.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH” dhe në zbatim të neneve 2, pika 2, germa “a”, neni 16 pika 6, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ të filluar me urdhrin e verifikimit nr. 49/1 prot., datë 03.02.2017, “Për disa parregullsi të pretenduara gjatë procedurës së vlerësimit në fund të periudhës së provës”, për shkak se nuk konstatohen shkelje në veprimin administrativ të kryer nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësit civil në periudhë prove, ***** në pozicionin “Inspektor i Dytë”, në Sektorin e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Durrës.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Departamenti i Administratës Publike dhe ankuesi *****.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA